



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 TETOR 2025**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 10. OKTOBRA 2025. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2025**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Dnevni red

1. Izbor Vlade Republike Kosova

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Dimal Basha.

KRYETARI: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të dashur qytetarë,

Të nderuar shkëlqesi ambasadorë të vendeve mike dhe Kor diplomatik i akredituar në Republikën e Kosovës,

Të dashur mysafirë të pranishëm në këtë seancë,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Fillimisht konstatoj se në seancë janë të pranishëm 113 deputetë, që nënkupton që janë përmbushur kushtet për mbajtjen e kësaj seance. Pra, po fillojmë punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas kërkesës së 42 deputetëve të Kuvendit me një pikë të vetme të rendit të ditës, që është:

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Të nderuar deputetë,

Kjo seancë për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës po mbahet plot 193 ditë pas fillimit të seancës së parë konstituive, që filloi më 15 prill 2025, kjo pas tri aktgjykimeve, të cilat gjithashtu morën 129 ditë, nga të cilat 45 ditë Kuvendi ka qenë nën masën e përkohshme.

Megjithatë, më 10 tetor 2025, Kuvendi përfundimisht u konstituua me sukses dhe në mbështetje të nenit 95 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, me Dekretin nr. 170/2025, të datës 11 tetor 2025, ia ka propozuar Kuvendit të Republikës së Kosovës zotin Albin Kurti kandidat për kryeministër për ta formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Me këtë rast ftoj kandidatin për kryeministër zotin Albin Kurti për të paraqitur përbërjen e Kabinetit qeveritar, si dhe ekspozenë e tij për mandatin e ardhshëm qeverisës.

Zoti kryeministër, fjala është për ju!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të kabinetit të ri qeveritar,

Të nderuar ambasadorë dhe anëtarë të Korit diplomatik,

Familje të dëshmorëve të kombit,

Zonja dhe zotërinj,

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës, z. Dimal Basha,

Nënkryetare Albulena Haxhiu,

Ju faleminderit të gjithëve për praninë tuaj dhe për përkushtimin që dëshmoni sot ndaj shtetit tonë.

Sot, mbi 6 muaj që prej thirrjes së seancës konstituive më 15 prill, më në fund kemi Kuvend të konstituuar dhe kemi arritur në pikën e formimit të qeverisë si materializim i rezultatit të zgjedhjeve të 9 shkurtit sivjet. Kjo është një vonesë e paprecedentë në historinë e Republikës, ku 5 nga këta 6 muaj deputetët ishin duke pritur Gjykatën Kushtetuese.

Kjo vonesë ka ndikuar në mbarëvajtjen e punëve shtetërore: janë vonuar marrëveshjet ndërkombëtare, Plani i Rritjes me Bashkimin Evropian, proceset e reformave dhe është lënduar besueshmëria e shtetit tonë para partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Në këta gjashtë muaj përpjekjet për ndërtimin e një shumice qeverisëse nuk dhanë rezultat, përkundër tentimeve tona të disahershme e shteruese. Asnjëra nga partitë parlamentare, të cilave u bëmë ftesë, nuk ka pranuar të hyjë në marrëveshje për bashkëqeverisje, megjithëse vota e qytetarit kësaj radhe kishte përcaktuar që duhej të kishte një koalicion qeverisës.

Po të pranohej oferta jonë për bashkëpunim, sot do të kishim mundësinë t'i jepnim vendit edhe qeverinë e re të koalicionit, por do të kishim edhe numrat e nevojshëm për të tejkaluar sfidën e zgjedhjes së presidentit, sfidë kjo e cila na pret pas 4 muajsh.

Sidoqoftë, si pasojë e mosgatishmërisë nga partitë e tjera parlamentare që të marrin përgjegjësinë që ua ka deleguar qytetari me votë, sot ndodhemi përpara një situatë ku qeveria e re propozohet për votim jo si produkt i një koalicioni politik, por si një akt i shërbimit ndaj vendit.

Ky votim sot nuk është thjesht formalitet politik, por përgjegjësi shtetërore.

Pa votimin e qeverisë së re, Republika rrezikon të shkojë në zgjedhje të reja pa shumë institucione funksionale dhe pa buxhet të miratuar për vitin e ardhshëm. Kjo do të nënkuptonte rrezikim të pagave për shërbyesit publikë, pensione, shtesave për fëmijë, asistencës sociale, furnizimit me barna, funksionimin e organeve të rendit dhe të sigurisë, por edhe të shumë projekteve kapitale që janë në proces e sipër. Një vend pa buxhet, është një vend që nuk mund të ecë përpara.

Në mungesë të një Kuvendi funksional gjatë këtyre muajve, janë edhe 33 agjenci dhe institucione të pavarura shtetërore që kanë mbetur pa mbikëqyrje institucionale. Kjo ka krijuar vakum drejtues, vonesa në vendimmarrje dhe rrezik në zbatimin e politikave publike. Ngjashëm, çdo ditë pa qeveri me kompetenca të plota është një ditë humbje për zhvillimin, për qytetarin dhe për shtetin. Për më tepër, përderisa nuk votohet qeveria e re, kjo nënkupton zgjatjen e mandatit të

qeverisë në detyrë. Pra, qeveri do të ketë, vetëm se deputetët e kanë të pamundur ta mbikëqyrin dhe të kërkojnë llogari nga një qeveri në detyrë, të cilën nuk e kanë votuar si legjislaturë e re.

Sot nuk jemi këtu për të ndarë pushtet, megjithëse kemi pasur ofertë të singertë për partitë e tjera për bashkëqeverisje, por jemi këtu për ta vënë pushtetin në shërbim të qytetarëve pa dallim dhe të Republikës sonë të përbashkët.

Prandaj, ftoj secilin deputet të Kuvendit që sot kur qeveria të hidhet në votim, të votojë jo thjesht për interes partiak, por për interesin publik e shtetëror, që t'i japim vendit qeverinë e re, të prodhuar nga rezultati zgjedhor i 9 shkurtit dhe t'u mundësojmë institucioneve vijimësi, duke e votuar buxhetin e vitit të ardhshëm.

Me të marrë besimin tuaj, të nderuar deputetë, 5 vendimet e para që do t'i marrim si qeveri që në javën e parë do të jenë:

Miratimi i projektligjit të buxhetit për vitin 2026; Vendimi për caktimin e pensionit minimal në vlerë prej 150 eurosh që prek rreth 200 mijë pensionistë; Vendimi për rritjen e shtesave për fëmijë me 50% mbi nivelin aktual që prek rreth 400 mijë fëmijë; Vendimi për rritjen e pagës minimale në 500 euro që prek një pjesë të madhe të punëtorëve në sektorin privat, gjithashtu prek edhe të rinjtë që janë të angazhuar përmes platformës “SuperPuna”, si dhe gratë lehona, të cilat përfitojnë nga shtesat; Miratimi i ndryshim-plotësimit të ligjit që mundëson heqjen e kufizimit të punësimit në sektorin privat për veteranët e UÇK-së që janë përfitues të benefitit të veteranit.

Janë edhe një sërë marrëveshesh ndërkombëtare që janë në pritje, përfshirë edhe Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian, e që do të jenë prioritet yni si qeveri që t'i sjellim sa më parë në Kuvend, dhe shpresoj që edhe ju, deputetë të nderuar, do të keni vullnetin që t'i mbështesni me votën tuaj.

Katër vjetët e fundit kemi ndërtuar, me krejt çfarë kemi ditur e mundur, themelet e një Kosove më të drejtë, më të fortë dhe më gjithëpërfshirëse. Kemi pasur rritjen ekonomike më të lartën në rajon, përkundër sfidave globale, me një rritje mesatare prej 6% dhe duke mos rënë në asnjë vit nën 4%. Sfidën e inflacionit që ka goditur të gjithë, kemi arritur ta menaxhojmë me politika mbështetëse për qytetarin dhe jemi vendi me shkallën më të ulët të inflacionit në rajon këto 4 vjet, pas Shqipërisë. Kemi shtuar punësimin nga 350 mijë të punësuar, në 430 mijë të punësuar dhe kemi rritur edhe të ardhurat e familjes, duke rritur pagën minimale, pensionet, shtesat për fëmijë, por edhe pagat në sektorin publik.

Kemi bërë shumë punë të mira, por kemi edhe shumë punë të tjera, të cilat na presin. Kemi liberalizuar vizat me zonën Schengen dhe tani pasaporta jonë e shtetit tonë të përbashkët është më e fortë se kurrë. Kemi përmirësuar imazhin e vendit, duke u ranguar në top lista për siguri

dhe rend, siç ishte ajo e institutit Gallup, dhe kemi siguruar edhe vlerësimin kreditor sovran BB-, që nuk është keq për fillim, gjë që na hap dyer të reja për investime të huaja direkte.

Rritja ekonomike po vazhdon, megjithëse kemi qenë qeveri në detyrë. Në tremujorin e dytë ishte 4.58% të BPV-së, dukshëm më e larta në rajon, dhe kjo për ata që shpesh e kontestojnë, është shkalla e rritjes reale, pra pasi që t'i hiqet inflacioni. Llogaritja e rritjes për tremujorin e tretë publikohet në dhjetor, e që gjithashtu pres të jetë më mirë se i gjithë rajoni, sepse këtë e konfirmojnë edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Është në dorën tuaj, të nderuar deputetë, që të na e mundësoni që të vazhdojmë punët e mira për vendin. Normalisht që për të gjitha veprimet, punët dhe arritjet e qeverisë, edhe mund të kemi mospajtime. Por kjo është vlera e demokracisë. Demokracia ka zëra të ndryshëm, ide të shumta, dhe debate të forta. Kjo nuk është dobësi, kjo është fuqi. Mospajtimet janë thelbi i sistemit demokratik, por ato nuk duhet të bëhen pengesë për të vepruar bashkë në çështjet madhore dhe për të ecur përpara si shoqëri dhe si shtet.

Ne jemi vendi më demokratik në rajon, një arritje kjo e përbashkët e qytetarëve dhe institucioneve tona dhe e të gjitha partive politike në Kosovë. Institucionet tona janë të ndërtuara mbi vullnetin qytetar dhe ky standard duhet të ruhet, të mbrohet dhe të zhvillohet.

Kuvendi është tempulli i demokracisë. Është vendi ku ballafaqojmë idetë, ku i debatojmë politikat dhe ku i kërkojmë zgjidhjet. Roli i Kuvendit në mbikëqyrjen e qeverisë duhet të forcohet, jo për ta ndalur qeverinë, por për ta bërë më të përgjegjshme.

Andaj pres që të debatojmë zellshëm për dallimet tona politike, por gjithnjë me respekt për njëri-tjetrin, për institucionet dhe për vullnetin e qytetarëve. Debat që mbështetet në argumente, dhe argumente që mbështeten në fakte.

Unë do të jem përherë i gatshëm, siç edhe kam qenë në këto katër vjet, për diskutime deri në shterim. Dy debatet e fundit të këtilla ku kam marrë pjesë kanë qenë: prezantimi për projektbuxhetin për vitin 2025, më 11 nëntor të vitit të kaluar dhe raporti im për qeverisjen katërvjeçare më 2 dhjetor 2024, me kërkesë të opozitës. Të dyja këto debate kanë qenë shumorëshe. Bashkë duhet të synojmë konsensus në tema madhore, si arsimi dhe shëndetësia, siguria dhe mbrojtja, politika e jashtme dhe ajo e energjisë.

Të dashur qytetarë,

Më lejoni së pari t'ju falënderoj juve, ata që votuan Lëvizjen VETËVENDOSJE! dhe ata që i votuan subjektet e tjera për pjesëmarrjen në zgjedhje, për shprehjen e vullnetit të lirë dhe për përgjegjësinë e lartë qytetare përgjatë gjithë procesit zgjedhor dhe pas tij.

Sot duket si kujtim i largët, por katër vjet më parë, në fjalimin tim inaugurues, Kosova ishte nën ethet e pandemisë, e ndërkohë u ballafaquam me kriza të shumëfishta. Nga pandemia COVID-19 që kishte tkurrur ekonominë dhe rënduar shëndetin publik e spitalet gjithandej, te kriza e energjisë dhe e inflacionit, e deri te provokimet e shumta, sulmet e shpeshta dhe agresioni i Serbisë.

Brenda një viti siguruam vaksinat në bashkëpunim me aleatët tanë dhe menaxhuam me sukses procesin e vaksinimit të mbi 60% të popullatës. Rikthyem shpresën dhe hapëm ekonominë, e cila u rikthye fuqishëm me një rritje prej mbi 10% në vitin e parë të qeverisjes, ndërkohë që patëm një mesatare vjetore prej 6% përgjatë mandatit katërvjeçar.

Kjo çoi në rritje të BPV-së, të buxhetit, e në hapje të vendeve të reja të punës.

Kriza globale e energjisë dhe rritja e çmimeve që kanë prekur çdo familje e çdo biznes, Kosovën e gjeti me një krizë të trashëguar të sistemit energjetik. Termocentrale të vjetra që janë jo vetëm ndotëse të ambientit, por edhe të ndjeshme ndaj çdo ndërprerjeje teknike.

Krahas sigurimit të energjisë dhe mbrojtjes së qytetarëve nga rritja e çmimeve përmes skemave të subvencionimit të faturave, investuam në tranzicionin e gjelbër me investime në energji të ripërtëritshme dhe në përmirësimin e efijencës. E nëpërmjet Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) u siguroa investim prej 236.7 milionë dollarësh në ndërtimin e baterive me kapacitet 170 MW (për rezerva 340 MWh), që e vendos Kosovën në vendin e parë në botë për kapacitet të baterive për kokë banori. Themeluam Bursën Shqiptare të Energjisë Shqipëri-Kosovë, ALPEX, dhe hapëm ankandin e parë solar prej 100 MW (në Kramovik të Rahovecit).

Në mandatin që na pret do të shqyrtojmë mundësinë e përdorimit të resursit më të vlefshëm që kemi, përdorimin e linjitit përmes gazifikimit për gjenerim të energjisë elektrike. Ky do të jetë projekti më i rëndësishëm në dekadat që do të vijnë.

Ofruam pakon më të madhe mbështetëse për përballje me inflacionin dhe krizën energjetike si përqindje e Bruto Produktit Vendor. Në Bankën Botërore kaluam nga përfitues në donator. Ndërkohë që shënuam rritjen më të madhe ndonjëherë në të gjithë indikatorët e demokracisë, sundimit të ligjit dhe të korrupsionit.

Unë nuk kam qenë vetëm kryeministër i shqiptarëve, por edhe i pakicave kombëtare apo i komuniteteve joshumicë, të cilët përbëjnë rreth 8% të popullsisë te ne dhe janë pasuri e shoqërisë sonë. Kemi lansuar masën e veçantë të punësimit për 2000 qytetarë të komunave të Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut dhe përveç kësaj, në Policinë e Kosovës janë të punësuar 199 kadetë serbë prej nëntorit të vitit 2022 e këtej, kurse nga pranvera e vitit 2023 i kemi mbi 100 serbë lokalë të punësuar me kontratë pune të rregullt në katër komunat veriore dhe mbi 200 të tjerë me kontratë mbi vepër.

Kemi ndarë 12,3 milionë euro për 149 projekte kapitale për komunat me shumicë serbe gjatë vitit 2023 dhe 11 milionë euro të tjera në 2024 për 150 projekte kapitale. Ndamë 3,9 milionë euro përmes Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për rrugë në vendet e banuar me komunitetet joshumicë në Dragash, Graçanicë, Istog, Klllokot, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Novobërdë, Partesh, Prizren, Ranillug dhe Shtërpçë, me gjatësi totale prej 65 km, dhe plus 1.8 milionë euro nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Shtëpinë e Kulturës dhe të Rinisë në Mamushë, si dhe gjysmë milion euro nga Ministria e Ekonomisë për projektin për ujë të pijshëm në fshatra me popullatë joshumicë në Rahovec. Në vitin 2023 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka dyfishuar mbështetjen e komunitetit joshumicë me 88 projekte të përkrahura me më shumë se 400 mijë euro, ndërkaq në vitin e kaluar ministria e njëjtë ka vazhduar mbështetjen për 73 projekte të tjera me vlerë prej 367 mijë euro.

Me bazën e re ligjore, është mundësuar shpallja e konkurseve për vende të punës vetëm për komunitetet joshumicë. Deri tani konkurse janë hapur në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, në Ministrinë për Zhvillim Rajonal dhe në Zyrën e Kryeministrit.

Të nderuar deputetë,

Gjatë këtyre viteve jemi përballur me provokime të vazhdueshme dhe me sulme të shpeshta të Serbisë, e cila solli katër herë brenda dy vjetëve të para qeverisëse ushtrinë në kufirin me Kosovën. Patëm dy sulme të mëdha terroriste, në Banjskë të Zveçanit në shtator 2023 që la të vrarë rreshterin e Policisë, heroin e Kosovës, Afrim Bunjaku, si dhe në infrastrukturën kritike në kanalin Ibër-Lepenc në Varagë të Zubin Potokut në fund të nëntorit të vitit të kaluar.

Ndërkohë kishim edhe barrikadat, bojkotimin e institucioneve dhe sulmet ndaj institucioneve të shtetit në veri të vendit, si dhe sulmet ndaj misionit të NATO-s, KFOR-it, Policisë së Kosovës dhe gazetarëve nga struktura kriminale të lidhura me Beogradin zyrtar.

Por, si kurrë më parë, u trefishua buxheti për Forcën e Sigurisë së Kosovës, u dyfishua numri i ushtarëve tanë, të cilët vijnë nga të gjitha komunitetet, u katërfishuan trajnimet jashtë vendit dhe u shumëfishuan investimet në blerjen e armatimit. Ndërkohë, kontraktuam sistemin antiraketor Javelin, dronët luftarakë Bayraktar, helikopterët Black Hawk, si dhe fabrikën e municionit. Së fundmi, arritëm marrëveshje për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes me Shqipërinë dhe Kroacinë.

Si rezultat, ushtria e Kosovës sot është më e fortë e më e madhe se kurrë më parë.

Në anën tjetër, Policia e Kosovës shkatërroi 135 grupe kriminale, mbylli 37 rrugë ilegale - 27 prej tyre në veri të vendit - ndërttoi 9 stacione të reja policore në veri për kontrollin e kufirit dhe,

në bashkëpunim me institucionet e ndjekjes, mbylli dhjetëra struktura ilegale në veri dhe anembanë vendit, të cilat për vite me radhë vepronin të paprekura e të papenguara.

E kryeterroristi dhe grupi i tij që vrau rreshterin e Policisë së Kosovës, heroin Afrim Bunjaku, u luftuan në një nga operacionet më të sofistikuar, që dëshmoi forcën dhe profesionalizmin e lartë të Policisë së Kosovës.

Sot, grupet kriminale që kryen sulmet terroriste në veri janë shkatërruar; strukturat ilegale janë mbyllur në masë; dokumentet ilegale janë zëvendësuar me ato të Republikës; dinari është zëvendësuar me euron; siguria është rritur, sovraniteti është forcuar dhe kryekrimineli Radojçiq është në arrati, i kërkuar nga Prokuroria e Kosovës me një aktakuzë prej 160 faqesh për të dhe 44 shokët e tij paramilitarë e terroristë.

Kosova sot, të nderuar deputetë, të dashur qytetarë, është më e sigurt se kurrë më parë.

Të gjitha këto sfida që i patëm, u përballuan me sukses. Ndërkohë që sfidat edhe i kemi kthyer në mundësi për progres.

Si kurrë më parë pra, investuam në ushtri dhe në fuqizimin e policisë, në shtrirjen e sovranitetit dhe luftimin e kriminalitetit; në politikat sociale për nënat e fëmijët, për të rinjtë e pensionistët, në mbështetje të fermerëve dhe bizneset e vogla. Prekëm çdo shtresë e çdo qytetar në çdo cep të Republikës.

Shteti që po ndërtojmë bashkërisht nuk zgjedh midis zhvillimit ekonomik dhe drejtësisë sociale, por i përqafton të dyja si shtylla të pandashme të progresit dhe të mirëqenies së përbashkët.

Ne besojmë thellësisht se një ekonomi e fuqishme dhe një shoqëri e barabartë janë të ndërlidhura, se bizneset dhe startup-et nuk janë vetëm motori i rritjes, por edhe kontribuues i mirëqenies së përgjithshme.

Vizionin tonë e realizojmë jo vetëm mbi parimet tona politike, si dhe mbi vlerat që i kemi të mishëruara në Kushtetutën tonë; mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, garantimin e dinjitetit njerëzor, të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe barazinë për çdo qytetar, pa dallim. Këto janë udhërrëfyes për çdo vendim që marrim, për çdo reformë që nisim.

Ushtria dhe Policia e Kosovës sot njëmend janë më të forta se kurrë më parë dhe Kosova është më e sigurt e më e drejtë dhe më e barabartë, por puna vazhdon drejt reformave të domosdoshme, e për këtë unë kërkoj pjesëmarrjen edhe të komuniteteve joshumicë, përveçse të shumicës shqiptare.

Do të vazhdojmë investimet që ta forcojmë sovranitetin për të garantuar që të gjithë qytetarët tanë të kenë paqe e siguri në familje, në rrugë, në lagje e në komunat e tyre, pavarësisht përkatësisë etnike, ata do të jenë të mbrojtur, të përfaqësuar dhe pjesëmarrës të barabartë në Republikën tonë.

Kosova është një dhe e pandashme dhe askush nuk do të jetë mbi ligjin, por as jashtë tij apo anash tij në asnjë pjesë të saj.

Institucionet tona sot janë më të besueshme dhe më të qëndrueshme se kurrë më parë, por jemi të vetëdijshëm që po jetojmë në një kohë të brishtë të sigurisë. Bota sot është shumë ndryshe prej asaj para pesë vjetësh, bota sot është më e paparashikueshme dhe më e pasigurt që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Nga Ukraina deri në Lindjen e Mesme tensionet po e transformojnë hartën gjeopolitike.

Kosova është rreshtuar në anën e paqes, të drejtësisë dhe të aleatëve të saj demokratikë. Aleanca jonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian, Mbretërinë e Bashkuar me NATO-n dhe me vendet mike nuk do të lëkundet, sepse ky bashkëpunim nuk është thjesht strategji, është vlerë. Sepse ne nuk jemi vetëm pjesë e kontinentit evropian, por pjesë e vlerave të tij: lirisë, solidaritetit dhe barazisë.

Në këtë kohë të ndryshimeve të mëdha, jam i bindur që nuk kemi mënyrë tjetër përveçse të gjejmë rrugën e bashkëpunimit për interesat vitale. Kërkesa e aleatëve dhe partnerëve tanë është e qartë: ne duhet të rrisim investimet në mbrojtje e në mirëqenie. Këtë e kemi bërë dhe do ta bëjmë edhe në vijim.

Në katër vjetët e ardhshme do të forcojmë aleancat, do të investojmë një miliard euro në mbrojtje, do të rekrutojmë ushtarë të rinj, do ta shumëfishojmë numrin e oficerëve, do ta funksionalizojmë fabrikën e municionit, do të zhvillojmë industrinë ushtarake të Kosovës dhe do të zhvillojmë dronët luftarakë “Made in Kosova”.

Nga kufizimi i lëvizjes e vetëkufizimi në anëtarësime e njohje të reja, siç e dini, përveçse u liberalizuan vizat me Bashkimin Evropian, Emiratet e Bashkuara, Izraelin e Tajlandën. U bëmë anëtarë në organizata e mekanizma të rinj ndërkombëtarë, aplikua për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, kurse Kenia e Sudani tashmë e njohin Republikën e Kosovës.

Sepse kur zhvillohet ekonomia, luftohet korrupsioni e krimi, kur fuqizohet sundimi i ligjit dhe institucionet, kur investohet në siguri, në paqe e në mbrojtje, kur rritet mirëqenia dhe investimet, hapen dyert e mundësive për të gjithë qytetarët dhe imazhi i shtetit përmirësohet.

Do të vazhdojmë të mbështetim fuqishëm Procesin e Berlinit dhe Tregun e Përbashkët Rajonal mbi bazën e barazisë dhe përfaqësimit të barabartë, sepse besojmë që fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal i kontribuojnë paqes dhe sigurisë në rajonin tonë.

Do të punojmë me këdo që shtrin dorën e bashkëpunimit mbi bazën e respektit të ndërsjellë.

Normalizimin e marrëdhënieve me fqinjin tonë verior, Serbinë, do ta ndjekim përmes dialogut, përmes marrëveshjes tonë bazike të Brukselit dhe aneksit të zbatimit nga Ohri. Por, siç kemi vepruar në katër vjetët e kaluar, normalizimi është çështje e rregullimit të marrëdhënieve mes dy shteteve, pra si raport bilateral e i jashtëm, e kurrësi ndërhyrje apo përzierje në çështje të brendshme. Qeveria do të mbrojë dhe do të zbatojë Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, në çdo cep të vendit.

Të nderuar deputetë,

Para nesh, kemi raundin e balotazhit për zgjedhjet lokale dhe në prill të vitit që vjen, në fakt, në mars të vitit që vjen, ato për president të ri të Republikës.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare misioni vëzhgues i BE-së raportoi se RT Balkan dhe Sputnik Srbija, të mbështetura nga Rusia, publikuan rreth 60 artikuj vetëm në janar sivjet për zgjedhjet në Kosovë, me qëllim përhapjen e dezinformatave dhe manipulimin e opinionit.

Lufta hibride është bërë normë. Nëse para pesë vjetëve ishte lajm aty ku kishte luftë hibride, sot është lajm aty ku nuk ka luftë hibride. Avancimi i teknologjisë dhe personalizimi i përmbajtjes në rrjetet sociale ka bërë që qytetarët të ekspozohen gjithnjë e më shumë ndaj informatave që ushqejnë atë që psikologët e quajnë “konfirmim i animit” - prirja për të besuar vetëm informacionet që përforcojnë bindjet ekzistuese.

Për fat të keq, lajmet negative dhe polarizuese tërheqin më shumë vëmendje dhe gjenerojnë më shumë klikime sesa ndonjë lajm pozitiv. Me ardhjen e Inteligjencës Artificiale, gjenerimi i përmbajtjeve të tilla është përshpejtuar dhe shumëfishuar dhe ky trend nuk duket që do të ndalet. Kjo është sfidë për të gjitha demokracitë, e Kosova nuk bën përjashtim.

Dezinformatat nuk është vetëm problem etik i gazetarisë, është kërcënim për sigurinë, për të vërtetën dhe për demokracinë. Zgjedhjet, demokracia dhe sistemi ynë ligjor varen nga e vërteta dhe nga një qytetar i mirinformuar.

Si shoqëri, duhet të lundrojmë me kujdes midis lirisë së shprehjes, që është themel i demokracisë, dhe dezinformimit që shfrytëzon këtë liri në dëm të saj. Ne jemi demokraci dhe Republikë, dhe asnjëherë asnjë qeveri nuk duhet t’u tregojë qytetarëve apo mediave çfarë të

thonë apo çfarë të publikojnë. Por, nëse duam që demokracia të mbrohet, atëherë është përgjegjësi e secilit që ta mbrojë atë.

Të nderuar deputetë, qytetarë dhe partnerë ndërkombëtarë,
Në mandatin që shkoi Kosova dëshmoi se është shembull i demokracisë dhe i zhvillimit në rajon, me rritjen më të madhe ndonjëherë në të gjithë indikatorët e demokracisë.

Tani është koha të tregojmë se jemi shembull i inovacionit dhe i drejtësisë efikase.
Në këtë mandat, reforma në drejtësi do të hyjë në fazën e saj vendimtare. Do të vazhdojë lufta kundër korrupsionit dhe ligji do të zbatohet pa frikë dhe pa favor në çdo cep të Republikës.

Reforma në drejtësi nuk ka qenë vetëm synim, ajo ka nisur të bëhet realitet. Ligji për Byronë Shtetërore për Konfiskimin e Pasurisë se Pajustificueshme duhet të ecë përpara së bashku me vetëqendrimin, ashtu që drejtësia të bëhet edhe e drejtë, edhe e shpejtë, edhe e besueshme.

Do të themelohet Prokuroria e re e specializuar për çështjet e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe zyra për hetime disiplinore.

Do të thellohet reforma në transformimin digjital. Çdo qytetar duhet të ketë mundësi të komunikojë me shtetin pa barriera, në mënyrë të shpejtë, efikase dhe transparente, nga aplikimi për dokumente, deri te shërbimet sociale dhe biznesore. Digjitalizimi nuk është qëllim në vetvete, por mjet për t'i shërbyer çdo qytetari dhe do të përdoret për progres shoqëror, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, llogaridhënie të gjerë dhe cilësi të lartë.

Në mandatin që lamë pas, eksportet dhe investimet e huaja direkte u dyfishuan, por tani është koha të shumëfishohet prodhimi. Përgjatë katër vjetëve në vazhdim do të investojmë rreth 1 miliard euro në prodhim përmes garantimit të kredive për investitorët. Bjeshkët tona të larta e të bukura nuk do të shijohen vetëm nga larg, por do të përjetohen nga afër, duke investuar në turizëm malor. Kjo do të fillojë me 500 milionë euro për Brezovicën, e cila do ta transformojnë atë në destinacion ndërkombëtar e evropian të turizmit.

Mërgata tashmë është pjesë jo vetëm në politikat e qeverisë, por është pjesë e bërjes së atyre politikave. Përmes “Dritares për investime të diasporës” do të mbështeten ndërmarrës nga diaspora deri në 100 milionë euro investime që bëhen në Kosovë.

Për të lehtësuar vizitat e mërgatës sonë në vendlindje, do të themelojmë edhe aviokompaninë shtetërore, projekt ky që besoj do të ketë edhe mbështetjen e LDK-së, sepse e kanë edhe ata në programin e tyre.

E për gjithë progresin që është bërë në rritjen e barazisë përmes shtesave për lehonat dhe fëmijë dhe për fuqizimin e grave dhe rinisë, do të fillojë projekti “Super Puna për gratë”, ashtu që kur punësohet një grua, qeveria do të mbështesë në lartësinë e pagës minimale gjashtë muajt e parë.

E gjyshërit që kujdesen për fëmijët kur të dy prindërit janë në punë, do të marrin 100 euro shtesë në muaj mbi pensionin bazë. Sepse kështu jo vetëm ndihmojmë prindërit dhe gjyshërit, por ndihmojmë familjen dhe ekonominë.

Paga minimale do të ndjekë rritjen ekonomike. Ajo do të rritet menjëherë, në javën që fillon nesër, në nivelin e 500 eurove, sepse një Kosovë që zhvillohet, nuk duhet të lërë askënd mbrapa. Pjesëmarrja nënkupton gjithëpërfshirje.

Në arsim kemi filluar reformën më të thellë në dekada. Nga arsimi i hershëm, deri tek ai universitar, po krijojmë standarde të reja cilësie dhe po rrisim investimet në infrastrukturë e në kapacitetet mësimore, edhe mësimdhënëse edhe mësimnxënëse. Janë ndërtuar dhe rinovuar çerdhe e shkolla, janë hapur qendra për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe arsimi po lidhet me nevojat e tregut dhe realitetin e sotëm. Ne duam arsim që ndihmon nxënësin të mendojë, të krijojë, të punojë, të zhvillojë e të ndërtojë.

Do të vazhdojmë të rrisim qasjen në shëndetësi, edukim dhe siguri sociale, duke i bërë këto shërbime më efikase dhe më të qasshme për çdo qytetar.

Do të përkrahim iniciativat kulturore dhe sociale që forcojnë ndjenjën e bashkësisë së komunitetit dhe përfshirjen e të gjithë qytetarëve në jetën publike, përfshirë këtu edhe infrastrukturën sportive që po ndërtojmë për ngjarjen madhështore të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030.

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në përputhje me atë çfarë pritet nga unë, përveç ekspozesë, të paraqes para jush edhe kabinetin e ardhshëm qeveritar, me të gjitha dikasteret e Ekzekutivit që del nga kjo legjislaturë e nderuar.

Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca,
Zëvendëskryeministër e dytë dhe ministër e Drejtësisë, Donika Gërvalla, Zëvendëskryeministër i tretë për Çështje të Pakicave dhe Bashkëpunim, Fikrim Damka,
Ministër i Financave dhe Ekonomisë, Hekuran Murati,
Ministër për Familje dhe Mirëqenie Sociale, Andin Hoti,
Ministër i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci,
Ministër i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla,
Ministër i Administratës Publike dhe Digjitalizimit, Lulëzon Jagxhiu,

Ministër i Shëndetësisë, Arben Vitia, Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Avni Zogiani,
Ministër i Kulturës dhe Turizmit, Fatmir Spahiu,
Ministër i Sportit dhe Rinisë, Blerim Gashani,
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, Rasim Demiri,
Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fitore Pacolli,
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja,
Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit, Dimal Basha,
Ministre e Tregtisë, Industrisë dhe Integritimeve Evropiane, Mimoza Kusari,
Ministre e Energjisë dhe Minierave, Artane Rizvanolli,
Ministër për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq,
Ministër për Zhvillim Rajonal, Sejmur Vejshall.

Zonja dhe zotërinj,
Kosova jonë është më shumë se një vend e një shtet.

Është ëndrra e mërgimtarit që ka lënë vendin dhunshëm me shpresën që do të kthehet së shpejti.

Është amaneti i dëshmorëve dhe sakrifica e gjeneratave që u flijuan e u përpoqën që ne sot të gëzojmë lirinë.

Është shpresa e prindit që sheh te fëmija një të ardhme më të mirë.

Është djersa e punëtorit, dëshmia e studentit dhe përkushtimi i mësuesit në një klasë në qosh të Kosovës.

Është fjala shqip që këndohet me mall në skaj të botës, e që kurrë nuk harrohet.

Është ndjenja që na bashkon në gëzim dhe në dhimbje, në fitore dhe në sfida.

Kosova është vend i zemrës, ku liria u pagua me jetë e ku paqja kërkon vëmendjen e përditshme.

Do të ketë vështirësi dhe vonesa.

Do të ketë dyshime dhe dekurajime.

Do të kemi dallime në qasje dhe mendime dhe nuk do të pajtohemi çdo herë, por ne kemi vullnetin dhe mjetet dhe burimet për të shërbyer dhe unë çdo herë do të jem me ju i sinqertë për problemet dhe sfidat që kemi përpara. Për një Kosovë të drejtë e prosperuese!

Ju faleminderit shumë për vëmendjen dhe për besimin tuaj! *(Duartrokitje)*

KRYETARI: Shumë faleminderit i nderuar kryeministër për ekspozenë.
Të nderuar kolegë deputetë, tani vazhdojmë, është koha e diskutimeve.

Fillojmë me përfaqësuesit e subjekteve, grupeve parlamentare. Kush flet nga Lëvizja Vetëvendosje? Deputeti Hekuran Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Më në fund, pra, siç e tha edhe kryeministri, është seanca e cila materializon procesin zgjedhor, pra kulmon me këtë, është votimi i Qeverisë së re, që do të duhej të dilte nga procesi zgjedhor i 9 shkurtit.

Si Lëvizje Vetëvendosje, si fitues të këtyre zgjedhjeve, ne patjetër që kemi synuar dhe kemi ofruar bashkëpunimin me të gjitha subjektet politike, pra me të cilat kemi vlerësuar se mund të bashkëpunojmë. Megjithatë, nuk ka pasur gatishmëri në anën tjetër.

Por, gjithsesi, konsiderojmë që vendit i duhet një Qeveri për të lëvizur përpara që të votohet buxheti, pra të tejkalohet sfida e buxhetit fillimisht, por edhe të votohen dhe të miratohen shumica e marrëveshjeve ndërkombëtare që tashmë janë në pritje, gjë që do të çlironte potencial prej qindra miliona eurove gjatë muajve në vijim, të cilat i duhen kaq shumë ekonomisë së vendit tonë.

Prandaj, patjetër që ne e mbështetim një Qeveri të tillë, patjetër që duhet të ketë Qeveri Kurti 3, sepse zgjedhjet janë opsioni më i keq. Zgjedhjet e reja janë opsion për të cilin ne nuk e preferojmë, nuk qëndrojmë për këtë opsion. E kemi thënë edhe nga fillimi. Prandaj, bëj thirrje edhe një herë të të gjithë kolegët deputetë, që t'i thërrasin arsyes dhe të lënë anash inatet politike, në mënyrë që t'i japim vendit një Qeveri pas kaq sa e sa muaj, në mënyrë që të materializohet vullneti i qytetarëve i dhënë më 9 shkurt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet Murati!

Atëherë, e vazhdon fjalën nga Grupi Parlamentar i PDK-së, flet z. Memli Krasniqi në foltore. Ju faleminderit!

MEMLI KRASNIQI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë e deputete,

Kryetar i Kuvendit,

Të respektuar përfaqësues të mediave,

Sot në këtë seancë, që do të duhej të ishte për një Qeveri të re, nuk dëgjuam ekspozë për këtë që do të duhej kinse të vinte, por më shumë e lexuam, apo e dëgjuam një rekuem për Qeverinë e kaluar, një panegjirik imagjinar për kinse të bëmat e saj, dëshmitarë të së cilës janë qytetarët e Kosovës më së miri.

Kanë kaluar mbi tetë muaj që jemi të bllokuar nga sjelljet arbitrare të partisë që e ka fituar numrin më të madh të deputetëve dhe kemi qenë dëshmitarë të një fjalamanie të “kemi, apo s’kemi vota”. Andaj, sa na përket neve si Parti Demokratike e Kosovës, koha e fjalëve ka marrë fund. Koha është që ta verifikoni atë që e keni thënë gjithë kohën se e keni arritur shumicën e re parlamentare.

Ka mbi tetë muaj që ju kemi dëgjuar z. Kurti duke thënë se konstituimi i Kuvendit është përgjegjësi e të gjithë deputetëve, ndërsa themelimi i Qeverisë është përgjegjësi e jotja.

Andaj, tani ju bëjmë ftesë që ta dëshmoni këtë përgjegjësi, duke e hedhur në votim menjëherë dhe sa më parë votimin e Qeverisë, që sapo e propozuat. Faleminderit!

KRYETARI: Nga LDK-ja flet deputeti Lumir Abdixhiku.

LUMIR ABDIXHIKU: Të nderuar zonja e zotërinj,

LDK-ja nuk sheh asnjë kuptim për debat sot kur mandatarin në fillim e pranon se s’ka shumicë. Dhe, nga këtu rrjedh dhe logjika bazike e seancës së sotme, se këtu nuk po e votojmë një ligj të zakonshëm, këtu sot do të duhej të lindte thelbi i vetë demokracisë, pra mazhoranca politike.

Dhe, nga mazhoranca më pas dalin edhe vendimet madhore për Republikën e Kosovës. Dhe, në këtë mungesë njohje bazike të arsyes se pse jemi mbledhur sot, në vend të ekspozesë të asaj që do të duhej të ishte Qeveria e ardhshme, dëgjuam një përmbledhje pune bukur fiktive, por të cilën e kemi kryer në legjislaturën e kaluar.

Tani jemi në legjislaturën e re. Tani, së paku duhet të kishim minimalisht dinjitet.

Dhe, dinjiteti të na vijë në formën burrërore, siç e themi ne, të pranoj se i kam apo s’i kam numrat, siç kam deklaruar tash e tetë muaj.

Të dashur deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mungesa e këtij dinjiteti ka sjellë në shkelje të paimagjinueshme plot 48 herë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Mungesa e këtij dinjiteti, të dashur deputetë e qytetarë të Republikës së Kosovës, ka sjellë situatën në të cilën një deputet është edhe kryeministër; një deputet është edhe ministër. Përkundër vendimit të Gjykatës Supreme, ne kemi uzurpatorë në detyrë në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Mungesa e dinjitetit politik, pra e pranimit të aktit të vetëm të thjeshtë logjik, se nuk kam numra, nuk është fundi i botës. Për tetë muaj e kanë mbajtur Kosovën të bllokuar, me arsye të ndryshme, me një Qeveri që s'e kanë me numra, s'e kanë me mbështetje as sot.

LDK-ja nuk sheh arsye për debat. LDK-ja nuk do të bëjë debat. LDK-ja s'do të dëgjojë fare asnjë debat. Na keni thënë numrat i kemi, na keni bllokuar për tetë muaj një shtet të tërë. Urdhëroni, mateni veten me numra demokratikë nga kjo legjislaturë.

Çdo arsyetim tjetër është dërgesë drejt zgjedhjeve të reja të jashtëzakonshme, te të cilat po shkojmë siç duket të gjithë. Ju faleminderit të gjithëve!

KRYETARI: Radhën e ka përfaqësuesi i subjektit politik Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući,

Poštovani,

U prethodnom periodu, u Vladi Kurti 1 i Kurti 2, doneli ste stotine odluka protiv interesa srpskog naroda. I ne samo protiv srpskog naroda, vi niste doneli nijednu dobru odluku ni za albanski narod. I zato ste prošli na izborima kako ste prošli.

Mi ne želimo da učestvujemo u ovoj diskusiji, želimo da dođe do glasanja, a da pošaljemo jasnu poruku da sva ona kršenja prava srpskog naroda su razlog tome da mi ne možemo i nećemo podržati ovakvu vladu. Hvala!

KRYETARI: Radhën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar AAK-Nisma. Kush flet? Deputeti Ramush Haradinaj, fjalën, ju lutem, regjia!

RAMUSH HARADINAJ: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kor diplomatik,

Media,

Të dashur qytetarë të Kosovës,

Ne sot kemi ardhur që ta kryejmë detyrën tonë të deputetit për të cilën edhe jemi kritikuar gjatë këtyre muajve nga të gjithë.

Ne e dëgjuam një shpjegim të deputetit që e ka marrë të drejtën t'i japë vendit Qeverinë, tani edhe zyrtarisht nga Presidentja. E pamë që ishte një lloj shfajësimi për gjendjen në vend, për problemet që i ka vendi. Kuptohet ka mundur të shfajësohej edhe një grimë më shumë. Ta shpjegojë pak edhe pse jemi nën sanksione, pse na është ndaluar dialogu strategjik. Pastaj, pse çmimi i energjisë është rritur kaq shumë, e kemi probleme në prodhim. Kjo listë do të mund të ishte e gjatë.

Tani, edhe ne si Aleancë nuk dëshirojmë, pra nuk e shohim të rrugës e të rendit që të debatojmë për një program qeverisës, të një qeverie në ardhje, sepse nuk na u dha. Nuk kemi asnjë material me shkrim të ndonjë programi qeverisës për vitet që vijnë, që është praktikë e zakonshme.

Pra, shihet që deputeti që u paraqit në emër të shumicës nuk fare ka program qeverisës. Nuk u është ndarë deputetëve, të paktën ta shikojë dikush.

Në ato premtime që i tha se do ta bëjë pagën minimale 500 euro, pensionet, lehonat, e disa premtime të tjera, nëse vijmë në Qeveri ne opozita, do t'i përmbushim pak më mirë.

Njëkohësisht, edhe investimet në siguri e në mbrojtje do t'i rritim më shumë. Kuptohet, në rend e ligj nuk duam të bëhemi me të korruptuarit, por me prokurorinë, me institucionet e drejtësisë, t'u dalim në krah atyre.

Për fund, i nderuar deputet, që u paraqite këtu në emër të shumicës, më habiti pak kjo arsyeja, pse e ceke luftën hibride sot, pra pas kaq vitesh ti në këtë foltore. Për mendimin tim, i nderuar, ti je produkt i luftës hibride të armiqve tanë. Pra, ty të kanë krijuar, ti e ke ushqyer këtë luftë hibride në këtë vend në vazhdimësi.

Ti ke punuar sistematikisht që të diskreditohet çdo vlerë e këtij vendi, disa prej të cilëve edhe i vuajnë pasojat sot nga drejtësia ndërkombëtare, disa më herët. Dhe, si i tillë, një ditë, po, është e vërtetë, lufta hibride e han atë që e ka ushqyer atë luftë. E tani të ka ardhur radha, besoj, edhe ty. Të uroj sukses!

KRYETARI: Radhën e ka Grupi Multietnik. Flet deputeti Elbert Krasniqi.

ELBERT KRASNIQI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Grupi Multietnik, i përbërë prej 8 deputetëve, e mbështet Qeverinë Kurti 3. Jemi mirënjohës dhe e vlerësojmë lart kontributin e Qeverisë Kurti 2 në përmirësimin e gjendjes dhe jetës së qytetarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.

Jemi të bindur që kjo mbështetje do të vazhdojë edhe në të ardhmen dhe për këtë, ne 8 deputetë do ta mbështetim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë.

Të nderuar kolegë deputetë, kanë përfunduar diskutimet.

Një sqarim i shkurtët procedural lidhur me zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë. Në bazë të nenit 96, paragrafit 5 të Kushtetutës së Kosovës, zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, pra po flasim për kandidatë për pozitën e ministrave, atëherë për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin në fjalë.

Në rastin tonë e kemi kandidatin Sejnur Vejshal, i cili nuk është deputet, prandaj para se të procedojmë me votimin e Kabinetit qeveritar, duhet ta marrim miratimin për ministrin e propozuar nga radhët e komunitetit joshumicë, joserb, të cilit i kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të komunitetit joshumicë, joserb.

Pra, me fjalë të tjera, të nderuar kolegë deputetë, nevojiten së paku 6 vota të deputetëve nga ky komunitet.

Të nderuar kolegë deputetë, jeni gati!

Lus regjinë dhe deputetët vetëm nga komuniteti joshumicë, joserb, të përgatiten për votim për kandidatin Sejnur Vejshal. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi 7 vota për. Me fjalë të tjera, konstatoj se kemi miratimin formal të shumicës së deputetëve nga radha e komunitetit joshumicë, joserb, për kandidatin e propozuar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Tani do ta marr prezencën e deputetëve të pranishëm në sallë. Prandaj, i lutem regjisë dhe deputetëve të bëheni gati që të votoni për prezencën. Votojmë tash!

Atëherë, prezent janë 110 deputetë. Pra, kemi kuorumin e mjaftueshëm për procedurë.

Të nderuar deputetë,

Tani dua t'ju njoftoj se në bazë të nenit 95, paragrafi 3 të Kushtetutës, Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Me fjalë të tjera, nevojiten së paku 61 vota për.

Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votimin e radhës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konstatoj se me 56 vota për, 52 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi nuk e zgjodhi Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju njoftoj se sipas nenit 95, paragrafi 4 i Kushtetutës, përgjegjësia tani kalon sërish te Presidentja, e cila pas konsultimeve me subjektet politike dhe brenda një afati prej 10 ditësh e ka mundësinë të emërojë kandidatin tjetër për kryeministër sipas së njëjtës procedurë.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Këtu i mbyll punimet e kësaj seance të jashtëzakonshme. Faleminderit dhe shihemi në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë